8SH-1-7
K 95

Gera gë ngjasin

891.983-1-7
K 95
8A-1
Kristo

«BIBLIOTEKA E NXËNËSIT»

S

ALQI KRISTO

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER
20320

GJËRA QË NGJASIN

NDËRMARRJA SHTETËRORE BOTIMEVE
Tiranë. 1958

Skicat punuar nga ZEF BUMÇI

Tirazhi: 3000 STASH: 2204-55

U shtyp në Stabilimentin «MIHAL DURI»
në Tiranë. 1958

PARATHËNIE

Më 1955 u botua vëllimi i parë i bibliotekës së Hostenit, antologjia «Kallinj pa bukë». Pas këtij vëllimi, brënda tre vjetëve, janë botuar njëri pas tjetrit edhe pesë vëllime të tjerë të kësaj biblioteke siç janë: «Gjëmbat e trëndafilit», vëllim me tregime humoristike i Miço Kallamatës; «Mëndja bën hata - Mëndja bën kala», skica e tregime të Moisi Zaloshnjes, «Koha s'lidhet me litar, poezi satirike e humoristike të Tonin Milotit; «Dardha e ka bishtin prapa», gjithashtu poezi satirike e humoristike të Dionis Bubanit; «Lëkura e ujkut», skica e tregime humoristike të Naum Priftit. Dhe ja tani lexonjësi ka në dorë vëllimin e shtatë të bibliotekës së Hostenit «Gjëra që ngjasin» të Alqi Kristos. Vetëm ky fakt, që brënda tre vjetëve u botuan shtatë vëllime, tregon se sa e mirë dhe me vënd qe inisiativa e kolegjumit të revistës Hosteni, që mori këtu e tre vjet më parë, duke krijuar serinë e botimeve të bibliotekës së kësaj reviste.

Me këtë rast nuk do të flas për të mirat dhe të metat që ka vëllimi «Gjëra që ngjasin» i Alqi Kristos. Një gjë është e tillë do ta bëjë kritika më von dhe do ta gjykojë vetë secili lexonjës. Por me gjithatë do të them përshtypjet e mija kryesore.

Po të tallesh me ato që nuk meritojnë vëmëndje, do të thotë të shkaktosh një gaz prej budallaj pa ide, pa përmbajtje, pra edhe pa asnjë përfitim. Porse një gjë e tillë nuk ndodh me poezitë e Alqi Kristos që ka përmbledhur në këtë vëllim. Ai satirizon dhe bën humor me fenomene që janë të kohës sonë dhe që janë me të vërtet pengesë për ecjen e shoqërisë përpara. Në të gjitha poezitë e këtij vëllimi shohim se autori ve përballë njeri tjetrit dy fenomene. Të vjetrën, që është duke u zhdukur, dhe të renë, që triumfon, — ashtu siç ndodh edhe në të vërtetë në jetën tonë. Nga ana tjetër, duke goditur e fshikulluar, ai njëkohësisht edhe edukon. Pikërisht këtu qëndron edhe vlera e këtyre poezive.

Ka raste në jetë që njerës të ndryshëm tregojnë një humanizëm prej budallaj kundrejt armikut, siç bën dellja me nëpërkën; ose ka njerëz të tjerë që shpërdorojnë pasurinë socialiste, burokratë të shkëputur nga jeta, sehirxhinj karshi ndërtimit të socializmit në vëndin tonë, kritizerë të sëmurë; ose fenomene të tjerë siç janë martesat me ndryshim të madh moshe, divorcet, bestytnitë etj. etj. Dhe pikërisht këto tema trajton edhe Alqi Kristua në këtë vëllim.

Ndërgjegjia e njerëzve tanë sa vjen e po shkarkohet nga shumë gjëra që na kanë lënë prapa. Kjo ka ardhur nga konditat materiale që janë krijuar e po krijohen për secilin dhe nga puna edukative. Edhe një nga meritat e autorit këtu qëndron për këtë poezi, sepse ai nuk e harron këtë anë, por e vë mirë në dukje: Gruaja e dënon aktin e burrit që ka prishur pasurinë e shtetit dhe ka bërë kënaçen për vehte, mblesat qahen tani se të rejat dhe të rinjtë e zgjedhin vetë bashkshortin apo bashkëshorten. Kështu, herë duke na dhënë psikologjinë e personazheve, herë duke mbajtur qëndrim vetë autori, Alqi Kristua na paraqit luftën e dy botëve që zhvillohet sot.

Dy fjalë edhe për realizimin artistik: Mendoj se vargu në këto poezi është i rrjedhshëm, pa sforcime, ka muzikalitet, figurat artistike janë të goditura dhe sqaronjëse të ideve, gjuhën e ka të bukur dhe të pasur. disa prej temave që trajton iu ka dhënë veshjen e fabulës,ku ja ka dalë me sukses. Në mënyrë të veçantë është realizuar bukur komedia me një akt «Tasi ndan gruan», së cilës nuk i mungojnë as forca satirike, as mjetet artistike.

Megjithkëto mendoj se vëllimi duhej t'ishte akoma më i pasur në tematikë. Nga ana tjetër për disa tema të caktuara, si burokracia, shpërdorimi i pasurisë socialiste, mburrja, bestytnitë, martesat me ndryshim të madh moshe, të pasurit frikë të kritikosh, tarafi etj., vërtiten nga vërtiten mendimet, por mënyra si paraqiten e si luftohen janë gati të një llojta në humoristët e satirikët që kanë dalë me vëllime deri sot. Dhe kjo gjë pothua vihet re edhe tek disa poezi të pakta të Alqi Kristos.

Është e ditur se temat janë njëlloj dhe kapen nga të gjithë shkrimtarët, në këtë rast edhe nga të gjithë ata që meren me satirën e humorin. Por çështja është që secili, duhet të kapi një anë të caktuar të së mirës ose të së keqes, kjo anë të mos jetë kapur nga të tjerët domosdo, dhe ta verë lexonjësin para një mendim të ri, që nuk ja kanë nxitur atij shkrimtarë të tjerë më parë, dhe ta bëjë lexonjësin pastaj që të nxjerrë edhe konkluzione të reja nga një poezi e caktuar p.sh., ose edhe nga një vëllim i tërë. Në këtë drejtim, bukur e në mënyrë të veçantë më duket ia ka arrijtur qëllimit autori me komedinë «Tasi ndan gruan». Ka mandej në vllim edhe poezi të këtij lloji, të cilat nuk janë të pakta.

Qartë dhe bukur më duket sikur janë përkthyer nga autori edhe pesë poezitë e fundit të Demian Bedni, Sergei Mihalkovit dhe të Samuel Marshakut. Mendoj se po të vazhdojë të përkthejë edhe të tjera si këto,

Alqi Kristua do t'u sillte mjaft shërbim qoftë gjinisë së satirës e humorit në letërsinë tonë, qoftë lexonjësve dhe edukimit të shoqërisë në përgjithësi.

Si mbyllje të këtyre dy radhëve dua të theksoj se vëllimi «Gjëra që ngjasin» është një pasurim i rëndësishëm për serinë e botimeve të bibliotekës së Hostenit, për letërsinë tonë satirike e humoristike në tërësi si gjini letrare më vehte, dhe një kontribut për edukimin e njeriut të ri sot tek ne ku çdo gjë po ribet e po lulëzohet, dhe edhe njerëzit vetë po riben me një botkuptim të ri e me një ndërgjegje të re.

Moisi Zaloshnja.

DELJA DHE NEPËRKA

Një dele e urtë
Dhe zëmërbutë
Tek po kulloste
Në një lëndinë
Në cingërimë,
Pa një nepërkë
Mbi dhen'e ngrirë
Q'ish tharë e mpirë.
«S'rri dot në ckëmka, —
I tha nepërka —
Se është ftohtë:
Mermë e mbështillmë
Me lesht' e ngrohtë,
Mua të, shkretën,
Shpëtoma jetën,
Pa në daç, nderë,
Ta laj në verë».
Delja manare
U pikëllua,
Zëmëra fare
I u copëtua.
«Ndonse ka ngrëmë,
— Tha, — time bijë,
Nuk duhet lënë

Që të mbërdhijë.
Gjynah nga zoti
Po ngorth së ftohti.»
Më gjatë s'priti
Mbi shpin' e ngriti,
Me lesh e pshtolli
Në vete e solli.
Kur dimri shkoi
Gjarpri s'mënoi
Për ta shpërblyer
Mikun e vyer:
«Cëk» e kafshoi
Dhe e helmoi
E bëri akull,
E fryu si shakull.
«Mosmirënjohës»
— Tha dele e shkretë, —
Tek po rrëzohej
Këmbëpërpjetë,
«Bëra të mirë
Keq e pësova
Ç'më duhej mua
Që të shpëtova?»

* * *

Mirë e pësoi
Delja manare
Se kishte ndjenja
«Humanitare».

PRISH BUCELA, BËJ KËNAÇE

Një marangos i mënçur si kadi
Një mbrëmje kur u kthye në shtëpi
Nga një ndërmarje shteti ku punonte,
Dëgjoi të shoqen tek e belbëzonte:
«Më duhet një kënaçe për në arë,
Pra bëj si bëj dhe sillma sa më parë.
Të nesërmen ky marangos i zgjuar,
Si s'gjeti material për ta ndërtuar,
Fët prishi një bucelë si me shkak
Dhe bëri një kënaçe për merak.
Në mbrëmje kur ia dha si një dhuratë,
E shoqia e shpërbleu si gjithë gratë:
Në njërën an' i mori shpejt kënaçen,
Dhe n'anën tjetër, fët i zgjati faqen.
Dhe marangozi tepër i gëzuar
I tha së shoqes si për t'u lëvduar:
Që ta ndërtonja atë ashtu si the,
Kam prishur një bucelë kreit të re!
Po kur mësoi e shoqja ç'kishte ngjarë,
Ia priti me inat e me të sharë:
Mor burr'i zi, ti dashke një kopaçe;
Si prishe një bucelë për kënaçe?
Po burri i foli hapur dhe pa hile:
Ti s'munt t'ia gjesh dot fillin marifetit:
Kënaçja është' e jona, moj xhahile
Kurse bucela ishte mall' i shtetit...

«Si ësht' babi nga shëndeti?»
Kurse babi ishte tretur,
Kish tre vjet që kishte vdekur!

RRON QË TË HAJË

Njoh një vashë qysh në shkollë
Syulli e vetullhollë
Fort e shkathët e zhvilluar
Si në mëndje dhe në duar.

Kisha kohë pa e parë,
Malli shumë më kish marë
Kur një ditë në mëhallë
Seç e ndesha ball' për ballë.

Shpejt e pyes: Si ke qënë?
Me shëndet si i a ke shpënë?
Pa më thuaj ku banon,
Si ke shkuar, ku punon?

— «Jam pa punë, tha, krenare,
Po kam shkuar mirë fare.»

Mbeta tepër i çuditur
Nga kjo fjalë e papritur!
Thuam, — thashë, — ç'të ka gjetur
Që pa punë paske mbetur?

Humbe, prishe, apo s'dite
A u lodhe, u mërzite?
Si jeton kështu pa punë?
Në s'gjen dot të ndih dhe unë.»

«— S'kam nevojë, tha, pa ndruar,
Nuk e di që jam martuar?
Sa kam burrin nuk kam gale
Se m'ushqen me bukëvale.»

KUR HUMBET NDËRGJEGJEN

Një trim që rreh për vete dit' e natë
Më thosh me zë të ulët e lëvdatë:
«Më shajnë shpesh që kurrë s'kritikoj,
Përmbys të kthehet, tjetrin s'e trazoj;
Po si njeri dhe unë kam parime
Nuk dua t'i ngas tjetrit as një qime.
Atë që s'dua të ma bëjnë mua,
S'ia bëj dot tjetrit, jo, se ma ka hua.
Këtë, mos thoni se e bëj për frikë,
Po kam një barrë mënt e kam llogjikë.
Të them të drejtën, ç'është e vërteta,
Këtë ma ka mësuar vetë jeta:
Po prek nj'epror, dhe munt të jem në hall
S'ma jep më buzëqeshjen që më ngjall
Dhe n'arthtë rasti munt ta pi së koti,
Atë që sjell minuta s'e sjell moti.
N'e paça nënë vete, nuk nguroj,
E shaj e kritikoj sa e dërmoj;
Po dhe këtu, ta dini, ka kufi
Në qoftë mik a shok a kushëri.
Më mirë rri e shitem si i thjeshtë
Se sa ta pi si qeni nëpër vreshtë,

* * *

Këtë ndërgjegje e shoi e mbyti frika,
Dhe s'vlen as dy para për shoqërinë,
Po dhe ata që trëmben nga kritika,
I a prishin ca më tepër terezinë.

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER
20320

BRESHKA E SËMURË

Zonja breshkë ish sëmurë
Sytë skuqur, ballin furrë,
Ethet rëndë e kishin zënë,
S'kish oreks as për të ngrënë.

Gjithë u trëmpn' u merakosën,
Tok u mblodhën u fjalosën:
Gjyshja, nëna dhe babai
Tetua, motra dhe vëllai,

Pastaj shkuan për të marë
Dr. Sorrën sa më parë.

Doktor Sorra, mëndjelehtë
E vështroi me sy të mprehtë
Namatisi dhe këndoi,
Nuskën fët e fët e shkroi.

Po ç'e do se breshk' e mjerë
Bëhej keq më keq përherë;
Kur e panë aq vështirë,
Doktor Qyqen, vajtn' e thirrë.

Dr. Qyqja ish pa shkollë
Nga kjo punë s'priste hollë,
Dha ilaçe si për plagë,
Lule shtogu dhe mëllagë.

Më von, breshka, me të ngutur
S'la faltore pa u lutur
Teqe, kishë dhe xhami
Hoxhë prift e perëndi.



Po ah, breshk' e gjorë ç'heq
Prit më mirë e na më keq!
Thirrën shpejt Doktor Guakun
Q'i dha barin për stomakun.

Dr. Bufi me ca shokë
Na i jep ilaç për kokë,
Dhe në funt Dr. Gallofi
Të sëmurën desh e cofi.

Kur i mbetën pak dit' jetë
Thrret doktorin e vërtetë;
Pasi erdh ky dhe e pa
Vrënjti vetullat e tha:
«Duhej bërë operacion
Po tani ësht' tepër von!»

* * *

Breshk' e mjerë, ashtu, sharroi,
Drodhi këmbën e mbaroi!

Ç'E DO MALL' E Ç'E DO GJENË KUR S'KE BURRË PËR TË QENË

(sipas një kënge popullore)

Kam një djalë mik, beqar
Them ta mar të mos e mar,
Thonë bota se pi shumë
S'di ç'të bëj e mjera unë.

— Ç'e do burrin thump e tapë
Kripë, ters e plot shamatë.

Kam një djalë si petrit
Që më lutet nat' e dit'
Po më thonë lot kumar
Them ta mar të mos e mar,

— Ç'do ta duash kumarxhinë
Që të shet edhe shtëpinë.

Kam një djalë qëngj manar
Them ta mar të mos e mar,
Po më thonë s'ësht' për punë,
S'di ç'të bëj e mjera unë.

— Ç'e do moj dembel' e mjerë
Zorrëthatë e rrobëçjerrë.

Kam një djalë fort të zgjuar
Po më thonë ësht' i shkuar!

— Ç'e do burrin plak të shkuar
Kokëdac e zemërshuar!

Kam një djalë trim beqar
Them ta mar të mos e mar
Thonë është djal'i mbarë
Dhe në punë del i parë
Ësht' i pashëm ësht i ri
As më lot e as më pi.

— Këtë djalë mos e shaj
Mere, bijë e mos i u ndaj!

DY MBLESAT

Qysh të kam moj motër, si ma ke kaluar,
Ç'qënke mplakur kaqë, ç'qënke dobësuar!
— Lermë mos më pyet s'po më vete mbarë
Bota u prish fare, iku koh' e parë,
Shkoi zanati ynë, mbaroi mblerësija
S'na e kthejnë kokën, ndroi njerëzija!
Mbetëm pa gostira, mitë dhe ryshfetë
Se çupat dhe djemtë, sot martohen vetë!

— Le çupat dhe djemtë që pika u rëntë,
Po dhe të mbëdhenjtë ku i kanë mëntë?
M'i lëshojnë vajzat posi ergjeletë
Nëpër dashurira pa mbushur njëzetë!
Ç'janë këto zyra, shkolla dhe mësime
Thjatro, kinemara, mbrëmje për dëfrime,
Bashkë djem e çupa n'arë dhe fabrikë
Na martohen çiftet pa paj' e pa prikë.

— Ah ç'na ish qëmoti, kohë e bekuar
Nderet që na bënin s'kishin të mbaruar!
Posa rritej vajza, bëhej për martesë
Mbyllej si një zonjë dhe kërkonte mblesë.
Vajza ish e urtë, s'kthente fjalë kurrë
Edhe plak të thinjur t'i jepje për burrë,
Do dëgjonte t'ëmën, bënte ç'thosh i ati,
Shkonte si një flutur, ku ta hithte fati.
— Dhe sa mirë dinin ta shpërblenin mblesën,
Kur me fjalë goje prishte e ndreqte vlesën!
Sot e bij' e botës ta pret me një herë:
«Burrin e gjej vetë, s'e pres nga të tjerë.»
Dhe s'e mbyll dot brenda se vete në punë
Me pahir s'martohet të tregon kanunë,
— Mbetëm gun' e vjetër, gas i njerëzisë
Shko i u qaj po deshe kohës dhe rinisë!

KËNDEZI I SHTËPISË

Kam një mik goxha njeri
Që fut tmerin në shtëpi
Se siç thotë këndenezi,
Në shtëpi këndon këndezi.

Posa hyn ay në derë
Priten fjalët me një herë
Gratë i bëjnë nder trimoshit
Posi pulatë kokoshit!

Nëna shpejt i mer ombrellën
Nusja pallton dhe kapellën
Shallin ia heq mbes e tija
Dhe këpucëtë e bija.

Pastaj njera sjell legenë
Tjetra shkon e bën kafenë
Hekurosin, bojatisin
Si një dhëndër e qindisin.

Gati dreka, gati gjella,
Për atë m'e madhe thela,:
Gati darka dhe mëngjezi,
Se këtu këndon këndezi!

Kur del jashtë bendenezi
Gjith familja ësht' e qetë
Se prej tij e shkreta ndezi
Posi pulat nga këndezi.

TË MORI MË QAFE...

Nga të gjitha shoqet ishe më e bukur
Qafënë të gjatë mesin të këputur,
Trupi yt i derdhur fytyra si hënë
Ndaj dhe Nasi Ferra syrin ta kish vënë.

Të kërkoi për grua djali pesdhjet vjetë
Kur ti s'kishe mbushur as edhe njëzetë.
Ç'i vështron, të thanë, flokët dhe të ritë
Kur e ke të pjekur e ke me pozitë.

Kur dëgjoi yt atë, brofi si në ëndër:
«Ç'fat, që shefin' e zyrës do ta bënte dhëndër!»
Ëmbël edhe ashpër ty të këshilluan
Rripat seç ti mblodhën, lutjet s't'i dëgjuan,
Të djel' u bë dasma me dit' e me natë,
Po të hënën herët erdhi një mandatë!
Shpresat u përmbysën, fati paska ndruar
Dhëndëri dhe shefi qënka degraduar!
Disa shoqe qeshën, po disa të qanë,
Të mori më qafë nëna me babanë,

MBURRAMANTIT

More, po jak në vete a derëzi,
Se mburje si këto që thua ti
S'kam parë e s'kam dëgjuar, pra s't'i mbaj
Se s'hahen as me uthull as me vaj.

— Të drejtë ke, dhe unë pas këtaj,
Këtë gjynah, pa tjetër do ta laj,
Sepse, si unë, asnjë njeri në botë
Nuk munt ta mbajë fjalën kur e thotë.

FSHATARJA E KUJDESESHME

Pa zbardhur mirë drita an' e mb'anë,
Kur fshati i përgjumur ndjeu çobanë
Që thirri të lëshonin bagëtitë,
Fshatarja shpejt u ngrit e moli dhitë.

Pasi mbaroi, ca qumësht veç e hoqi
Në një kusi e fshehur nga i shoqi,
Për në pazar u nis ajo ta shpinte
Me enën përmbi kokë që mënt binte.

Në rrugë, tek po shkonte, mëndjen vriste
Ç'do blinte pasi qumështin ta shiste,
E si mendoi thellë e më nge
Vendosi që të blinte disa ve;

Nga vezët, kish ndër mënt se pas një mot
Do nxirte zogj e ve e pula plot,
Të cilat kur t'i shiste në pazar
Do blinte lopë, qe dhe një gomar,

Nga gazi u hoth përpjetë plot hare,
Po enën me kujdes e la përdhe,
Sepse, mejtoi, me gjith' atë të hedhur
Do binte ena poshtë e do qe derdhur.

* * *

Fitoren, tha edhe n'e paç në thes,
Të shkon nga dora shpejt kur s'ke kujdes.—

NUSKA NUK E MBYTI UJKUN

Një hoxhë i mënçur, mik i Perëndisë,
Q'i shiste nuska shumë njerëzisë.
Kur pa se njerzit nisën ta përçmojnë
Mejtoi t'ia shiste nuskat bagëtisë,

Një ditë pra, fshatarve nis t'u flasë:
Në doni q'asnjë dëm të mos ju ngjasë,
U varni bagëtive nga një nuskë
Dhe shihni që as ujku s'do t'i ngasë.

Po një fshatar i tha me qesëndi:
Filloje nga të tuat efendi;
Në mos i hëngërt ujku ato me nuska,
Ahere bëjmë ashtu si thua ti.

Dhe hoxha, dhisë nusk' i vë, me shpresë
Se ujku, ndonse shumë i pabesë.
Nuk ka se si ta gjejë dhin' e hoxhës
Gjersa kullot në mezin e kopesë.

Mek. Nr. 6 SH. 7. SH. S.

Po q'atë ditë, ujku i mallkuar,
Teksa kish dalë malit për të gjuar,
Na bije përmbi dhinë e efendiut
Dhe e fshi me gjithë nuskën e bekuar!

Në fshat sa mbriti lajmi menjëherë
Të gjithë qeshnë e i thanë hoxhës mjerë;
S'ta shajmë nuskën, hoxhë efendi,
Po duhet që dhe Balua të mos flerë...»

KUSARI DHE FSHATARI

Një herë e në një kohë një kusar
Na zuri, në një pritë, një fshatar,
Që kthehej nga pazari në shtëpi,
Ngarkuar plot një kalë e një gomar.

Si e kërkoi dhe e ropi mir' e mirë,
Dhe ç'kish e ç'nukë kish i a pati fshirë,
Me plaçka e torba e kafshë dhe para,
Në fund e la të ikënte i lirë.

Kur s'kish as dhjetë çapa q'ish larguar,
Kusari e thirri prapë i penduar
Dhe si e kontrolloi dhe një herë,
I gjeti një sahat të mrekullueshëm!

«Kusar, — i tha fshatarit, fort nevrik, —
Këtë ma fshehe me qëllim të lik;
S'ke turp, të turpërohesh, edepsës,
Mendove të ma vjedhësh kaq' açik!?»



DIELLI DHE ERA

(Fabulë)

Fryjti er' e malit
Solli një furtunë
Bariu i kopesë
Mbështillet me gunë.

Fryn e çfryn tufani
Erë e shi, shtërngatë
Që bariut t'i marë
Gunën me shamatë.

Po s'ia heq dot gunën
Era dhe rrebeshi
Se më fort çobani
Përmbi trup e ngjeshi.

Dielli prapa reve
Tek po e shikonte
Qeshi, se furtuna
S'dinte të punonte.

I tha: «Shihmë mua
Si do t'ia heq gurën»
Dhe me hap të sigurt
Shpejt e nisi punën:

Rrezet lehtë-lehtë
I a dërgon ngadalë
Gjersa gun' e leshtë
Ngrohet, bëhet valë,

Ahere bariu
Nuk duroi e s'priti
Nga e nxehta gunën
Tutje e vërviti.

Nuk mbarohen punët
Me zhurm' e rrëmujë
Më mirë mbarohen
Me mënt e pa bujë.

Demian Bedni

UJKU DHE DELJA

Gjahtor m'i egër ish nga gjithë ujqit,
I pari i lukunisë, armik për bujqit,
Po ja tek shtrihet, do të vdesë,
Drobitur, mbetur keq, pa shpresë.

Ashtu siç ish, një dele sheh për bri.
E thret edhe i lutet për mëshirë:
«O dele e urtë e dashur, zëmërmirë
Gjaksor kam qënë, e di,
Po e shkuar e harruar.
Sot jam duke mbaruar.

Ca dhën më zëmërliga, le t'i mbajnë mënt ç'kam bërë,
Po ti harro ç'ke hequr, krimet falmi që të tërë
Edhe më ndih të zbres të shuaj etjen në përrua,
Të mbyt dhe hidhërimin

Se sot po shoh mbarimin.
I bëj pra një të mirë, një armiku që u dërmua.
Po delja i u përgjegj e qetë: «Të mar vesh fort mirë:
Të pish, të vish në vete.

Të t'vijë dhe oreksi e të na hash si këto vjete.
Dhe e nis me... lamtumirë !»

Sergei Mihalkov

LEPURI I DEHUR

Iriqi, për ditlindje na fton edhe një lepur
Me rrobat e së dielës ky niset zemërprekur.
Me miqtë ish biseda e ëmbël plot dëfrime
Me pije mbushur vëndi, bollëk kish dhe ushqime
Ndaj lepuri s'kurseu për të pirë,
Aq shumë piu sa humbi dhe fiqirë.
Ndajnatë i meren këmbët fort nga pija
E thret me zë sa tundet themelia:

«Do t'ikëj në shtëpi, se mjaft kam pirë !»
«Jo, shok, i tha iriqi, ti s'je mirë:
Kam frikë mos të gjen ndonjë rrezik,
Pra sonte fli këtu, i dashur mik,
Mos humb dhe udhën, s'di se nga i a mban
E pyllit, thonë, gjëndet një luan.»

— «Luan, the? Bah! E ç'është ay për mua?
Ia ndreq samarin unë, kur të dua!
I jap një grusht, i a rjep atë lëkurë
Dhe mishin i a coptoj, i a pjek në furrë»

Kur nëpër pyll rent lepuri si trimat
Të gjithë ç'qenë, i zgjoi nga sokëllimat:
— «Luani? Bah! E kam si copë bukë
Kam ngordhur plot të tillë piçirukë»
Përtiste aqë fort me këto profka
Sa zgjon e nxjerr luanin që nga shtrofka.
Ky rëndë, rëndë e zë për mjekre e e mpin:
«Kush është ay që prishi gjumin tim?
Ah, Zoti lepur! Dehur! Ta ujdis,
Mejtoj që të të varr në këtë lis.»

Shpejt u bë esëll lepuri i mjerë,
Si ta shpëtonte kokën këtë herë?
Më gjunjë pra përkulet sa më parë
Luanit zë i lutet duke qarë:

«S'kam dashur të të bëj asgjë me kast,
Për nder, më mirë vdes që këtë çast
Se sa t'i sjell një dëm zotrisë tënde
Që je fisnik sa s'ka në këto vënde.

Tani... posa kam qënë... tek një mik...
Dhe piva fare pak... ca them açik,
Po krejt dolli për ju e bëra pijen,
Për ty, për gruan tënde dhe fëmijën...»

Luan' i tmershëm kthetrat lemeri,
Si ushta fët i mblodhi përsëri
Dhe lepurin vendos të mos e ngasë
Se lajkat, ky luan, i desh pa masë.

Sergei Mihalkov

ZOGJTË E STËRKUJDESESHEM

Një herë Ariut i del në zverk nj'i thatë
Që nuk e lë të flejë as dit' as natë
Dhe doktor Shtërku q'ish usta i ndjerë
U thirr t'ia çante plagën menjëherë.

Doktor i vyer vrejti mbar' e prapë,
E kqyri nga çdo anë atë të thatë
Dhe si mejtoi thellë, u vrënjt i tërë
Pastaj filloi të thotë ç'duhet bërë:

«Në pastë ndaj mëngjezi keqësim,
Do bëj me shokët, tha, një konsultim.
Tani ia pshillni paq me një pecetë;
T'ia lidhë doktor Kukuvajka vetë.»



Me Kukuvajkën vjen Dr. Këndezi,
Se i sëmuri ish keq gjer ndaj mëngjezi
Dhe në mëngjes aty nga ora shtatë
U mblodhën mjekë plot për një të thatë
Dhe si e kqyrë e bënë konsultim
Njoftuan: «S'munt të bëjmë operim.
Kjo dhëmbje, gjer në mbrëmje po ta mbajë,
Do thresim Dr. Strucin që t'ia çajë,
Ay ka sqep të gjatë
Dhe kthetra për të thatë».

Ndërkaq, mbi shtrat t'Ariut një bletë hypi
Dhe i sëmuri për një çikë e shtypi
Po bleta nxori thumbin e pickoi
I çpoi ariut të thatin edhe shkoi.

Doktorët u kënaqën nga kjo punë
Jo se ariu, në fund, do bënte gjumë
Po se tani të gjith' përgjegjësinë
E mori bleta vetë përmbi shpinë.

Këtë, mos e shpjegoni, zogj-doktorë
Se bleta vjen vërtet t'ju japë dorë.

Samuil Marshak

AS SHUMË I MIRË AS SHUMË I LIK.

Dy shënja paska budallai në botë:
Atë që bën edhe atë që thotë.

Kur nis një punë, fundin do ta ketë
Të kthyer prapsh a kokëtatëpjetë.

«Çatinë, sefte», — thotë, — «zuri shi,
E s'lagem të bëj mur' e themeli»,

Kur pusi nga shtpia lark i ndodhet
Me shoshë e mbush ujët, të mos lodhet,

Dhe derën pas e mer kudo të vejë
Q'asnjë kusar mos mundë t'ia shpërthejë.

Përmbi çati i ngjit lopët që të hanë.
E thotë q'u pëlqen kjo panoramë.

Po mbi të gjitha, një i ka përlqyer:
Gërvishtje hijeve mbi mur të lyer.

Ky budalla, ka dhe lezet të plotë
Se s'e mer vesh ç'do bëjë e ç'do thotë.

Mërzitet kur të gjithë po gëzohen
Gëzohet, kur të tjerët hidhërohen.

Në dasmë, (siç e dini) është zakon
Dhe plaku budalla plot qejf këndon,

Kërcen siç i a do zëmra e zi s'mban,
Po budallaj i ynë, zë e qan,

E lotët na i rrjedhin si rrëke
Si t'ish varrim, jo dasmë dhe hare,

Nga kjo dasmorët fort u zëmëruan
E më të ngrihen shpejt në dru e shtruan

Të gjithë ç'ishin nga një grusht i futën
I çorrën faqet, shpinën seç i a zbutën,

I nxinë sytë, rrobat i a coptuan
I skuqën hundët, brinjët i a dërmuan.

Pastaj me gjith' ato gjymtime shtatit,
E hodhën brënda në haus të fshatit;

Kur dolli u mejtua gjat e gjërë:
«Përse më rrahën vallë, ç'faj kam bërë?

«Me ta s'u talla, vetëm, u tregova
Sa fort për nusen, unë u hidhërova...

«Ah, herën tjetër duhet t'u tregoj
Se di dhe të kërcej e të këndoj».

Dhe rasti seç i erdhi pa vonesë
Kur një varrim i u duk se ish martesë

Karroca shkonte rrugës mengadalë
Dhe pas korteu, përzishëm e pa fjalë.

«Të shkretët, — tha, sa janë pikëlluar!
«U duhet një njeri për të kënduar.»

Dhe shpejt në turmë hyn, t'i ngushëllojë
Me gjithë zëmër nisi të këndojë;

Pastaj kërcen një valle me gëzim
Pa vënë re vështrimet plot qërtim.

Po njerëzit nga kjo u zemëruan
E prapë e zunë aty, në dru e shtruan;

Të gjithë ç'ishin nga një grusht i futën
Kërbishten, brinjët, shpinën prap' ia zbutën.

E hundët i a gjakosën, rrobat çarë
Ç'ta zgjat, pestil e bënë si më parë.

Pastaj me gjith' ato gjymtime shtatit
E hodhën prapë në haus të fshatit.

E prapë u mejtua gjat' e gjërë:
«Përse më rrahën, vallë, ç'faj kam bërë?

«Ah, po, tani fort mirë e kam kuptuar
«Nuk duhet as të qarë as të kënduar,

«Gëzimi, hidhërimi, duhen fshirë
«S'u dashka as shum' i lik, as shum' i mirë,

«Pra duhet të ndryshohem pak or mik
Mos t'jem as shumë i mirë as shumë i lik.»

Dhe qysh ahere, fajin shpejt e ndreq:
Sido të shkojnë punët, mirë a keq,

As gas as helm nuk çfaq se s'do t'i njohë,
Ose i çfaq të dyja në një kohë...

Tani as qesh as psherëtin më kot
Dhe sytë kurrë nuk i mbush me lot;

As ngroh, as ftoh, nuk futet në bela
Kushdo bën be që s'është budalla.

Dhe kjo është' provë e madhe, pa mungesë,
Çdo gjë e sheh, po vetë nuk mer pjesë:

Ngreh sytë rrobaqepësi, shikon
Dhe e pyet budallanë: Si po shkon?»

Po ky tregon ca peshqë që ka zënë
Dhe e pyet: «Kanë shijë për të ngrënë?»

Fëmijët i tregojnë ndonj' ushtrim,
«Shiko» i thonë ësht' mirë a gabim?»

Po ky mer peshqit, pallton për të shkuar
Dhe u heth një sy të ftohtë e të menduar,

Një sy që s'meret vesh se çfarë do
Se nuk të thotë asgjë, as po, as jo.

Përgjigja më e qartë që të jep
Ësht kjo: «As shum' i mirë, as shum' i keq»,

A n'ësht se do ndryshohet pak or mik
Mendon: «As shumë i mirë, as shumë i lik!»

Tani të shohim pra nga gjith këto:
A është e vërtetë ajo e kjo?

A ësht' ashtu-kështu, siç' mendon thellë?
Sepse diçka do ketë nën kapellë.

Ay panden se jemi ne çkallmuar,
Pra duket q'është budalla i zgjuar.

HUAJA E DJALLIT

Ç'gjë ësht më keq», — një plak i varfër, thosh:
«Kuletën apo barkun të kesh bosh?»
E me që vetë, i kish të dyja trokë,
Në ndihmë thirri Djallin e i thotë:

«I dashur djall i prapë, lutem shumë,
«Më huaj dy florinj se kam një punë
«Pa t'i kthej prapë, — shpirtin vë rehen,
«Me gjysmën e fitimit që do kem».

Premtimi e kandisi përnjëherësh:
U çua shpejt ky bujtës i skëterrës
Me thundër dysh edhe me bisht të gjatë,
Në dorë duke mbajtur grusht paratë
E thotë: «Na florinjtë që kërkon
«Po kur ma kthen atë që më takon?»

«Rehen të lashë shpirtin, ç'do nga mua,
Dy fish do ta laj nesër këtë hua».

Këtë premtim ky Djall me gas e mer
E fët e fët e shkruan në defter,
Pastaj si i mori firmën mirë e mirë
U çduk, me bisht, me thundër e me brirë.

Kështu ky plak na vete në pazar
Plot mallra ble e shet si tregëtar
E me këto na nxier aq fitime
Sa ble një depo mbushur me ushqime...

Të nesërmen pagdhirë u ngrit përgjumë
Dhe me që kish ushqime aqë shumë
Ha radhë nga të gjitha ç'kishte vënë
Për gjith' ato mëngjeze që s'kish ngrënë.
Pastaj tek binte prapë në jatak
Ndjen Djallin që trokiste, tak, tak, tak, !

Fërkoi plaku sytë me mërzi
E tha: «Dëgjo mor Belzebub i zi:
Lëxo defterin, duket ke harruar
Që borxhin nesër kam për ta paguar,
Goj' hapur mbeti djalli nga kjo fjalë
Kroi kokën edhe shkoi me bisht në shalë.

Të nesërmen ay trokiti prapë
«Më jep — tha, — shpirtin tënt ose paratë!»
«Na ruajt perëndia! Qënke i ngeshëm,
«Përse prish gjumin e njeriut të ndershëm?

«Afatin nesër' vetë e kemi vënë,
«Defterin humbe a mëndja të ka lënë?
«S'dallon dot ditët ferri? Pse ma zgjat?
«Këpute qafën se do mar inat !»

Përgjigje, ditën tjetër, përsëri,
Nuk mori, veç gërhitje e gogësi,
Për borxhin a rehenin, as një fjalë
Dhe kjo e zemëroi tepër, Djallë...
«Po hyra brënda. tha. s'ta bëj të gjatë,
Ahere di se t'i mar paratë!»

Një ditë, hyri brënda e kërkoi,
Po përmbi mur këtë shënim këndoi:
«I dashur Djall», qe shkruar me edukatë,
«Të lutem eja dje e mer paratë.»

Kroi prapë djalli kokën mbi lëkurë
E tha: «Siç shoh kjo «nesër» s'arthka kurrë
Se «sot» ne quajm' ditën që agoi,
«Pagesa s'bëhet dje, ajo mbaroi !»

KËSHTJELLA E RIGËS

Sikur të gjenja vetë një thesar
Me xhevahire plot edhe me ar,
Kalan e Rigës blinja, mure-lartë,
Sëbashku me të zotët kryelartë
E do t'ua prishnja jetën plot të mira,
Me salltanete shumë e me gostira,
T'i vinja të punonin, jo më shumë,
Se ç'kam punuar gjithë jetën, unë,
Në fusha e në pyje dit e natë,
Mëngjes e mbrëmje, në thëllim e vapë;
Pastaj nga dhëmbja e lodhja do shikojnë
Se si fitohet buka që ngjërojnë.

TASI NDAN GRUAN

(Komedi me një akt)

P E R S O N A T:

Tasi Grëpsha — burrë 35 vjet
Shega — e shoqia, grua e pakët dhe e dobët së cilës i është prishur bukuria.
Mandi, — i vëllaj i Shegës
Nasi, — vërsnik e shok i ngushtë i Tasit.
Sofia; — e shoqia e Nasit, e bukur dhe e lëvizur.

Sken' e parë

Një dhomë banimi e pajisur me orendi të zakonëshme. Nasi i ndezur ecën tutje e tëhu nëpër dhomë. Sofia rri këmbë mbi këmbë në një kanape e pi duhan.

NASI : — Ta kam thënë copë e prerë
Pik së pari ruaj nderë!
SOFIA : — Ç'ësht' kjo fjalë që më thua,
Mos ke gjë dyshim për mua?
NASI : — Pse del jashtë kur s'jam unë?
SOFIA : — Nuk dal kurrë, veç për punë,
NASI : — Mos gënje se të kam parë!
Kur kërkon të dalç e larë,

Ca më fort ma shton mërzinë,

SOFIA : — Shpirt, e lërë xhelozinë !
Ti e sheh sa fort të dua,
Ta dish, s'jam e tillë grua,
Po si duket s'më njeh mirë.

NASI : — Sofi, hiqma këtë frikë !

SOFIA : — Në i vënça burrit brirë
Më rëntë që lart një pikë !

NASI : — Mu beto që s'tradhëton.

SOFIA : — Të betohem, gas mos pafsha
Në skëterrë e gjallë vafsha;
Short mos paça asnjë herë,
Mbeça qyqe dhe e mjerë,
Lumturi mos gjeça kurrë,
Në të ndroj me tjetër burrë! (E përqafon dhe e puth,
Troket dera dhe hyn Tasi)

TASI : — Mirëmbrëma zoti Nasi

NASI : — Ohoooo! Mirse erdhe Tasi.

TASI : — Si po shkon, a ke mërzi ?

NASI : — Shumë mirë, bukuri !

TASI : — Po ty nuse, si të kam ?

SOFIA : — Nga shëndeti mirë jam,

TASI : — Me shëndet edhe me fat

NASI : — Shko moj grua, mos e zgjat,
Sillna ndonjë gjë të pimë,
Mezen, gotat dhe rakinë. (Sofia del)
Si ia shpie me shëndet ?

TASI : — Shëndet kam, po s'kam kësmet,

NASI : — Pse o Tasi, ç'të ka gjetur ?

TASI : — Shihmë o Nasi si jam tretur !

NASI : — Opopo si qënka bërë!
Ç'të ka ngjarë. Tani thuam...

TASI : — E kam punën keq me gruan,

NASI : — Si, mos vallë tradhëtoi ?
TASI : — Jo, derbardhë, atje s'dyshoj !!
Kam një tjetër hall me të.
NASI : — Thuam, ndofta të ndihmoj.
TASI : — Nuk e di sepse s'e dua,
Ç'të të them, nuk bën për mua !
Është tretur, është nxirë,
Është tharë është mpirë
Është bërë si cirua!
Më vjen turp që e kam grua !
NASI : — Pse s'e ndan a derëzi,
Ç'vjen vërdallë e si vë drunë ?
TASI : — Mor e ndaj dhe që tani,
Po kjo nuk varet nga unë.
Ndarja s'është pun' e lehtë.
NASI : — Si mor s'është pun'e lehtë ?
Shko në gjyq dhe mbaroi puna
TASI : — Gjyqi të kërkon shahitë,
NASI : — Po ti përse i ke miqtë?
TASI : — Ja, tamam për këtë punë
Të kam ardhur edhe unë.
Në më do e me ke mik
Më shpëto nga ky rrezik.
NASI : — Po mor Tasi, pun' e lehtë
Dëshmitar në gjyq dal vetë.
TASI : — Pra padinë ta kurdisim,
Mirë e bukur ta ujdisim
Që dhe punën ta mbarojmë
Edhe gjë të mos pësojmë. (Hyn Sofia me raki dhe meze)
NASI : — Domosdo po ësht' më mirë
Ta fillojmë me të pirë (Mbush gotat Sofia, del)
Bromp e rrofsh e qofsh, o Tasi!

TASI : — Bromp, na rrofsh dhe ti o Nasi! (Pinë)
Pa, pa, pa, ç'raki e mirë !
NASI : — Ësht' e fortë, safi rrush.
Mbaje gotën të ta mbush.
TASI : — Falemnderit. Ja gëzuar !
NASI : — Qofsh me nder. Dhe ti gëzuar ! (Pinë)
Març një nuse sa më parë.
TASI : — Po unë akoma s'jam ndarë.
NASI : — Ajo punë ka mbaruar,
Mjaft o Tasi ke duruar!
TASI : — S'munt të jetë kaq' e shpejtë.
NASI : — Nuk vonon, se ke të drejtë
TASI : — Pa ta bisedojmë shtruar.
NASI : — Bromp, gëzuar !
TASI : — Ja gëzuar ! (Pinë)
E ç'mardha mejton ti vë
Se pa shkak nuk mund ta lë.
A të them që s'ësht' e zgjuar,
Ësht' e trashë e pa mësuar ?
NASI : — Kjo akuzë është bosh
Do të thonë «ta mësosh!»
TASI : — A të them s'më bindet mua
Ndaj s'më ngjitet e s'e dua ?
NASI : — Ashtu le që humb davanë
Po do gjesh edhe belanë.
TASI : — Po ahere mund të themi
Q'ësht' nevrike, mëndjelehtë
Asnjë çast s'më le të qetë;
Gjithë grindje, kot, pa punë
Po më ha si krimbi drunë,
NASI : — Ja, tamam ashtu do bërë,
Ashtu si bëjnë të tërë:
«Ësht' e prapë si piperi
Nuk na piqet karakteri».

TASI : — Shumë mirë na e gjete
Në gjyq duhen marifete.
Po ti Nasi ç'do të thuash ?
NASI : — Them o Tasi ç'far' të duash.
Munt të them që të kam parë
Kur të grint e të ka sharë;
Munt të them që kam dëgjuar
Dhe në dru kur të ka shtruar.
Në daç them që shet dhe ndërë
S'të do ty, po do të tjerë,
TASI : — Hë, ashtu të lumtë goja
Se dhe unë atë kërkoja.
NASI : — Mbushe gotën pra të pimë
Ja gëzuar !
TASI : — Qofsh gëzuar ! (Pinë)
NASI : — A s'ia mer një herë shtruar ?
TASI : —; A ma pret dot ti o Nasi ?
NASI : — Si s'ta pritkërkam o Tasi (Këndojnë)
Moj raki moj bukuroshe,
Që më heth qoshe më qoshe,
Moj raki moj zëmra ime
Na mbush jetën me gëzime;
Lum ay që pi rakinë
Me një tra e ka shtëpinë,
Lum kush pi raki dhe verë,
Xhepin plot e ka përherë.
Të këndofshim dhe për dasmë
TASI : — Të lumtë goja, o Nasi !
NASI : — Më fal një minutë, o Tasi
Sot se si harrova fare
E kam mbetur pa cigare, (Del, hy-
TASI : — Mbaroi puna, u prish martesa
Se mos më dalësh nga besa !
SOFIA : — Mos dysho o shpirt aspak,

Rri i qet' e pa merak:
Sa të ndahesh, q'atë ditë,
Vij të jepem pa konditë (e puth vjedhurazi)

NASI : — (Sofisë duke hyrë)
Shko na ziej nja dy ve
E i bjerë për meze.

TASI : — Jo, më shumë s'munt të pi.
Do të ikij në shtëpi,
Ish raki e fortë shumë,
Na rëndoi e më vjen gjumë,

NASI : — Pakëz fare, kemi pirë,

TASI : — Jo, do t'ikëj, lamtumirë

NASI : — Si të duash, lamtumirë.
Tani që e bëmë planë
E ke mu në xhep davanë (Del Tasi)

Sken' e dytë.

Një dhomë ndenjeje, e pastër dhe e rregulluar mirë. Shega pret të shoqin pranë zjarrit duke bërë një triko. (Trokitje në derë)

TASI : — Ç'e ke mbyllur këtë derë.
Apo do të ndezësh sherrë ? (Troket)
Hape moj tu thaftë dora! (Troket)

SHEGA : — (Duke hapur derën) Po ç'të bëra un' e gjora
Që më çkrihesh tërë inat ?

TASI : — Mbylle gojën, mos e zgjat !

SHEGA : — Pak se të pres si e shkretë
Gjer në orën dymbëdhjetë,
Po më vjen i dehur tapë

Me të thirur e shamatë.
TASI : — Moj po ty në mos ta bëfsha,
Ashtu siç e kam mejtuar
Mos më thënçin Tasi Grëpsha.
SHEGA : — Pse mor çfarë ke mejtuar?
TASI : — Të të shpije tek yt-atë
Se shumë të kam duruar.
SHEGA : Të më shpijesh tek im atë ?
S'të vjer turp, je bërë tapë
Dhe nuk di se ç'farë flet
TASI : — Edhe ti s'e di ç'të pret.
E sheh nesër babaxhanë
Kur të shkoj të hap davanë.
S'të mbaj dot më në shtëpi.
SHEGA : — Je në vete mor i zi ?
Ç'janë këto që më thua ?
TASI : — Po të them se nuk të dua
Dhe kur them s'e shkel më fjalën.
SHEGA : — Më ngadal se do zgjosh djalën.
Po pse do më ndash mor burrë,
Këtë gjë s'e prisrja kurrë,
Sepse neve s'jemi zënë,
Kaqë dendur s'jemi ngrënë,
Aqë fort s'të kam mërzitur
Që të ndahesh krejt pa pritur.
TASI : Atë — punë e di vetë
Nuk durohet më kjo jetë !
Në familje, dit' e natë,
Ngrysem, gdhihem me shamatë :
«Jo po pse i prish paratë
Pse vjen në shtëpi me natë ?
Pse ke ngrërë, pse ke pirë,
Pse s'ke shoqëri të mirë ?
Pse nuk shkojmë për vizitë,

Pse nuk dalim asnjë ditë
Për shëtitje, për hava.
Në theatër, kinema ?
Edhe punët e shtëpisë
Nuk m'i bën si çdo amvisë :
Shpesh kur kthehem i kapitur
S'gjej asgjë të pregatitur.
Çdo gjë shkretë çdo gjë metë,
Sa dhe çizmet i heq vetë.
Sofrën e gjej të pa shtruar
Edhe gjellën pa gatuar.
Kur sjell gjellën, ç'gjell e shkretë ?
Ja e ftohtë, ja e nxehtë,
Ja pa zjerë, ja ronitur
Ja pa kripë, ja e kripur !
Nga këto ra vjen dhe sherri
Unë, e di seç heq, i mjeri,

SHEGA : — Bah, ç'i ke gjith këto gjëra?
Gjë të ligë s'të kam bërë
Unë po ti bëj të tëra
Që në pe e në gjëlpërë.

TASI : — Mbyll moj gojën e uruar
Ajo punë ka mbaruar !

SHEGA : — Po për djalin, s'të vjen keq ?

TASI : — Vafsh me gjithë' të në dreq ?
Vallë ç'faj kam unë i m'eri
Që s'na piqet karakteri?

SHEGA : — Oh, këto mos m'i shit mua
Ti do marësh tjetër grua,
Se të gjitha këto gjëra
Janë çpifje që të tëra,
Jo se s'jemi zërë kurrë
Po punën se kemi shpurë
Për t'u ndarë, asnjë herë

Se nuk jemi vrarë e prerë.
E ku jemi zënë ne ?
Shumë lehtë e shumë rallë.
Po ti e ke gjetkë hallë:
Do një grua më të re !

TASI : — Ja si çpif, tani ç'të bëra ?
A durohen këto gjëra ?

SHEGA : — Po ahere, pse më ndan ?
S'jam e prapë e s'ke ç'më shan.

TASI : — Ç'kisha për të thënë e thashë.

SHEGA : — Po më thuaj, mor qyq,
S'të vjen turp të dalç në gjyq.
Me të tilla marrëzira ?

TASI : — Unë kam arsye plot
Se s'më le rehat një ditë
Ta provoj dhe me shahitë.

SHEGA : — Të provosh ca të pa-qëna.
Po ta dish se s'të kam frikë,
Sot nuk jam e skllavëruar,
Shkoj zë punë në fabrikë
Dhe rrit djalin të mësuar.
Koha s'është si qëmoti
Kur s'i terej gruas loti.
Edhe unë, domosdo,
Nuk të dua, kur s'më do.
Po ta dish pra që më parë
Se pa gjyq s'të jap të ndarë;
Le ta dinë që s'ke hak
Dhe më ndan pa ndonjë shkak.

TASI : — Këto prova s'janë pak,
Gjyqi do më japë hak. (Perdja)

Sken' e tretë.

(Tasi pret të dashurën në shtëpi. Bën tualetë e spërkatet me kollonjë. Ëndërron se si do ta presë Sofinë duke bërë gjeste përpara pasqyrës)

Hyn Sofia e tronditur.

SOFIA : — Më në fund o shpirt, shpëtova
Mora syt' e fluturova!
Lashë burrin e shtëpinë,
Të shijojmë dashurinë! (I hidhet në qafë dhe e puth me zjarr).

TASI : — Ah, e dashur, ç'lumtëri !

SOFIA : — Të më ndjesh o Perëndi !

TASI : — Mos ki frikë Perëndinë
Vet' e bëri dashurinë.
Ç'faj i kemi ti e unë
Që pa faj në kurth u zumë ?

SOFIA : — Ke të drejtë, s'duhet lutur.
Gjersa jemi kaq të lumtur.
Eja rrim' e bisedojmë
Njeri tjetrin ta gëzojmë (Ulen mbi një kanape)

TASI : — Kaq të lumtur s'e kam ndjerë
Veten, time, asnjë herë! (E pushton)

SOFIA : — Ja, kështu, përgjithëmonë
Do ta shkojmë jetën tonë (e pushton)
Pa më thuaj, s'më tregove,
Gjyqin sot, si e fitove ?

TASI : — U përpoqa me sa munda
Po për pakëz desh e humba.
Nasi s'diti e s'më mbroi
Planin tonë e ngatërroi.
Un' shpëtova me një dackë
Po ay u zu në grackë

Edhe shkon në burg një vit
Se dolli jallan shahit.

SOFIA : — Ah, i gjori ç'ka pësuar;
U bë: fare gas i botës

TASI : — Vuri festen sipas kokës (qeshin)

SOFIA : — Po me Shegën, si e bëre ?

TASI : — Gjyqi paskërka hatëre.
U çuditëm kur dëgjuam:
«Tasi s'munt të ndajë gruan,
Se s'ka prova, s'ka të drejtë
Po i ka kurdisur vetë».

SOFIA : — Obobo, ç'na paska gjetur,
Tjetër shpresë, ç'na ka mbetur ?

TASI : — Mos u trëmb se Shega vetë
Na e ndreqi me të shpejtë.
Me inat u hoth e tha:
«Më dëgjoni edhe mua
Këtë burrë, për bela,
Si s'më do, ashtu s'e dua ».

SOFIA : — Puna ahere ka mbaruar

TASI : — Siç e deshmë ka mbaruar !
Paskëtaj do rrojmë bashkë
Fort të lumtur, të gëzuar.

SOFIA : Nuk e di pse jam tronditur
Mos na ngjasë gjë papritur.

TASI : — Sa ke burrë babaxhanë,
Festen të ma vesh më nj'anë
Se në mos me dhelpëri
U a mbleth me trimëri.
(Nasi thrret që jashtë.)

NASI : — O Tasi !

SOFIA : — Pupupuu na erdhi Nasi !

TASI : — Vërtet moj, ay të jetë ?
Ç'qëllim vallë do të ketë ?

NASI : O Tasi!
SOFIA : — Oboboo, tani ç'do ngjasë?
TASI : — Më vjen frikë mos më vrasë!
Po tani si t'ia bëj hallë?
SOFIA : — Tani dil e i bëj ballë !
TASI : — Pik e zezë ! Gjeç belanë!
Shko e mbyllu shpejt m'at'anë !
NASI : — Aty je o more, Tasi!
TASI : Këtu or këtu, (Hyn Nasi)
NASI : — Kjo hata që më ka ngjarë,
S'është ndjerë e s'është parë!
TASI : — Ç'është o Nasi, ç'të ka gjetur?
NASI : — Ah sikur të kisha vdekur
Këtë gjëmë kaq të ndytë
S'do ma kishin parë sytë.
TASI : — Thuam pra, ç'të ngjau kështu?
NASI : Mbeta vetëm si kërcu.
M'iku gruaja, më la,
TASI : — Jo derbardhë, bën shaka.
Gruaja ashtu e ka,
NASI : — Tasi, mos u tall me mua!
Po kësaj këtu, ç'i thua?
Shiko letrën plot mëri
Që ka lënë në shtëpi (Tasi lexon letrën)
TASI : — Q'ato ditë q'u martova,
Me ty, jetën s'e gëzova
Rrojta qyqe dhe e mjerë
Lot e brenga për nga herë!
Jetën fare ma ke nxirë
Dhe prandaj të le të lirë
Se kam burrë më të mirë!
Lamtumirë!
TASI : — S'është për tu çqetësuar,
Do të jetë zëmëruar

Ose do të të provojë
Dhe kurdisi këtë lojë.

NASI : — Mua po më luan mëndja.

TASI : — Kudo qoftë është tëndja.

NASI : — S'bëhet një shaka e tillë.
Nëm o Tasi një këshillë.
Ku të ketë vajtur vallë?
Thuam ti, si t'i a bëj hallë?

TASI : — Po në qoftë e vërtetë
S'ke ç'i bën, se ka të drejtë,
Gruaja sot është e lirë,
Shkon atje ku rron më mirë,
S'e mban dot, po të mos dojë.

NASI : — Edhe të më turpërojë ?
Të më shkojë nga shtëpia?
Ku është nderi, burrëria?
S'e nxij unë këtë faqe
Se jam burrë me mustaqe.
E lë unë atë të gjallë
Të më qeshë e të më tallë?

TASI : — Pse o Nasi, ç'ke ndër mënt?

NASI : — Nderin do ta ve në vënt!
Këtë turp s'e mbaj dot kurrë
Do ta vras me gjithë burrë!

TASI : — (I trëmbur) Je në vete, mos u çmënde?
Do të humbësh vehten tënde!
Po i vrave, s'ke shpëtim
Ja litar, ja pushkatim!

Nasi : — Mor m'i gjej t'i vras
Pa dhe unë vdes me gas.

TASI : — (I trembur) Mos e merr me gjak të nxehtë
Pa mejtohu pak dhe vetë:
Pse të derdhësh gjak më kot

Ndarja, turp nuk është sot.
Le t'i shajë njerëzia
T'i dënojë perëndia.
Mos u a mer gjynahet ti,
Shko martohu përsëri.
Pastaj burri, ç'faj të ka?
Faj ka shoqja që të la!

NASI : — Mor po do ti vras të dy
Më plaçin këta dy sy!
Ja se si do tu a dënt: (Bën sikur nxjerr revolen dhe duke ia drejtuar Tasit, e ndjek disa hapa kur ay tërhiqet i trëmbur).
Një, dy, tri, dënk, dënk, dënk!

TASI : —, Po ne jemi shokë o Nasi!

NASI : — E pse trembesh ti o Tasi?

TASI : Ke vërtet me vehte armë?

NASI : — Kam or kam, jam bërë gati?
Do ti vras, ashtu qe fati. (Hyjnë Mandi dhe Shega)

MANDI : — Këtu je mor çartalan?

TASI : — Zoti Mandi, pse më shan?

MANDI : — Edhe pyet pse të shaj?

TASI : — Unë i mjeri nuk kam faj.
Motra jote s'ka pse qahet
Deshi vetë që të ndahet.

MANDI : — Me këto nuk lahesh dot
Se e mbushe kupën plot!

TASI : — Nuk mar vesh, a vjen si mik
Apo ke qëllim të lik?

MANDI — Ti do vrarë, mor rezil!

TASI : — Të më vrasësh? Oh i shkreti
Ç'ësht' kjo gjëmë që më gjeti!
Zoti Mandi, nuk kam faj,
Ki mëshirë, mos më ngaj.

MANDI : — Mos m'u lut, se nuk ta fal.
TASI : — (Me vehte) Ja tani, mbarova fare
I rrethuar nga dy zjarre!
Nga t'i a mbaj i mjeri unë!
NASI : — More Mandi ç'është kjo punë,
Thuam pse e frikëson?
Pse ke ardhur, ç'dëshëron?
MANDI : Erdhëm për të marë plaçkat
Q'i përkasin motrës s'ime,
TASI : — S'mbaj prej saj unë as një qime,
Po prit sa t'i bëj gati,
T'i sjell vetë në shtëpi,
MANDI : — Do t'i marrim që tani,
TASI : — Zoti Mandi, ki durim
Ki besim në nderin tim,
Ta sjell vetë gjithë gjënë,
Po tani jam shumë i zënë!
SHEGA : — Ti shih punën, rri i qetë
Unë plaçkat i mbleth vetë (Drejtohet për në dhomën ku ndodhet Sofia, Tasi i del përpara i alarmuar)
TASI : — Aty s'hyn pa lejën time!
MANDI : — Në e do me kërcënime,
Ta ndreq qejfin si të duash! (E kërcënon me grusht,
Tasi tërhiqet i tmeruar, Shega hap derën e dhomës dhe shtanget në vënt duke lëshuar britmë habije)
SHEGA : — Ah!!! (Sofia del sikur s'ka ndodhur gjë, ndërsa Tasi qëndron i strukur e i frikësuar me kokë ulur),
SOFIA : — Përse bëhet kjo shamatë?
NASI : — Oh e dashur, këtu je?
Unë thashë se më le,

Se s'ma merrte mëndja kurrë
Që të bësh këtë shaka ! (Niset ta përqafojë)

SOFIA : — Ikë tutje, budalla
Mbylle shpejto këtë skenë
E mos dil shahit i remë,
Mer një nuse sipas kokës
Dhe e mbro prej gjithë botës
Duke e mbyllur, nat' e ditë
Të mos shohë as diell' as dritë,
Sa për mua mos ki frikë,
Të më rrojë Tas Petriti
Që e diti dhe e vërtiti, (E përqafon)

MANDI : — Eja t'ikim sa më parë
Këta janë për të vrarë, (Perdja)

PËRMBAJTJA:

	Faqe
Parathënie	3
1) Delja dhe nepërka	7
2) Prish buccla, bëj kënaçe	10
3) E humbi toruan	12
4) Rron që të hajë	15
5) Kur humbet ndërgjegjen	15
6) Breshka e sëmurë	17
7) Ç'e do mall' e ç'e do gjënë	19
8) Dy mblesat	21
9) Këndezi i shtëpisë	23
10) Të mori më qafë	25
11) Mburamanit	27
12) Fshatarja e kujdesëshme	27
13) Nuska nuk e mbyti ujkun	29
14) Kusari dhe fshatari	31
15) Dielli dhe era	33
16) Ujku dhe delja	36
17) Lepuri i dehur	38
18) Zogjtë e stërkujdesëshëm	40
19) As shumë i mirë as shumë i lik	42
20) Huaja e djallit	48
21) Kështjella e Rigës	52
22) Tasi ndan gruan	53